



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira - Department of Freelance Professions

Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.29/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.331/14, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ,pala ankuese dhe që të dy nga fshati , dhe Përmbaruesi Privat, me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-29/2022 i datës 07.11.2022 dhe ankesa e palës ankuese e datës 14.10.2022 **si të pabazuara.**

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.331/2014.

A r s y e t i m

Me datën 14.10.2022 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat me pretendimin se përmbaruesi privat ka bërë keqpërdorim të pozitës zyrtare duke u bazuar në dokumentin fallco të

Sipas palës ankuese dokumenti është i fallsifikuar pasi nuk ka pronë në asnjë vend të Kosovës e që dëshmohet edhe me vendimin mbi trashëgiminë, me të cilin vendim të trashëgimisë është i njoftuar edhe përmbaruesi privat. Pala ankuese në ankesën e tij ka theksuar poashtu se përmbaruesi ka bërë bllokimin e llogarive dhe nga shuma e pranuar si pension, ka bërë pagesat e këtij obligimi. I kanë **propozuar komisionit që të ndërmerren masa ndaj përmbaruesit privat në proporcion me shkeljet e bëra.**

Me datën 07.11.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka theksuar se inicimi i procedurës disiplinore është i pa bazuar, pasi nga prendimet ankimore të debitorëve nuk mund të kuptohet fare se cilat janë shkeljet e përmbaruesit, ndërsa komisionit i ka dorëzuar vendimet e gjykatës ku është vendosur për kërkesat e debitorëve dhe prapësimin e tyre.

Në seancën dëgjimore të mbajtur palët kanë deklaruar se nuk kanë pronë fare në emër të tyre dhe ka dokumnetacion fallso të kompanisë, duke kërkuar nga komisioni që përmbaruesi të shpallet përgjegjës, ndërsa përmbaruesi ka deklaruar se i njëjti e ka bërë bllokimin e llogarisë së lejuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Këtë konstatim komisioni e bazon në dokumentin përmbarimor, faturën dhe kartelën e debitorëve e cila është dorëzuar nga kreditori, vendimet e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.331/2014, dt.27.02.2015 dhe PPP.nr.267/2017, dt.22.10.2018, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5107/2018, dt.08.03.2019 dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me nr të rastit KI70/19, dt.08.08.2019.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.25/2022 datë 22.12.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.